



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201203713/16

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** Rekomandohet "Vënia në dispozicion menjëherë e akteve të procedimit penal nr.1323 të vitit 2011, për të cilin Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datën 10.07.2012, ka marrë vendim për pezullimin e hetimeve, qytetarit V. Q., nga Tirana".

**Drejtuar :** Drejtorit të Policisë së Qarkut  
Z. Ardian ÇIPA

**Për dijëni:** Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor  
Z. Petrit FUSHA

**TIRANË**

*Të nderuar Zorërinj,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi V. Q., banues në Qesarakë, pallati i firmës ndërtuese "Zaimi", Linzë të Tiranës, i cili ka ngritur pretendimin se nga Prokuroria dhe Policia nuk i vihen në dispozicion aktet e procedimit penal nr.1323 të vitit 2011, për të cilin organi procedues ka marrë vendim për pezullimin e hetimeve. Për rrjedhojë mosvënia e tyre në dispozicion i ka sjellë pengesa për zhvillimin normal të seancave gjyqësore në procesin civil, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke ndjekur me shqetësim ankesën e qytetarit V. Q., më datën 11.06.2014, me shkresën nr. K2/V46-11, kemi kërkuar informacion Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila më datën 24.06.2014, informon ndërmjet të tjerave Institucionin e Avokatit të Popullit se: "...më datën 10.01.2014, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, ka rregjistruar procedimin penal nr.223, për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186/3 të Kodit Penal, pa autor. Hetimet e këtij procedimi penal janë ende në vazhdim".

Në shkresën tonë "Kërkesë për informacion" të datës 11.06.2014, drejtuar Prokurorisë, kemi patur parasysh shqetësimin e qytetarit V. Q., se në séancë

gjqësore të zhvilluar me objekt kundërshtimin e vendimit të datës 10.07.2012, marrë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për procedimin penal nr.1323 të vitit 2011, në të cilin është vendosur pushimi i akuzës ndaj shtetasve Myzafer Memushi dhe Luljeta Kongoli, dhe pezullimin e hetimeve, nuk janë paraqitur aktet e dosjes.

Nga përgjigja e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë e datës 09.07.2014 sipas shkresës nr.8984/1, jemi informuar për faktin se dosja penale nr.1323 e vitit 2011, është pezulluar dhe aktet e kësaj dosje i kanë kaluar Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë me nr.5890 protokollin datë 27.07.2012. Bashkëlidhur është dërguar dhe fotokopje e fletës së librit të dorëzimit

Një fakt të tillë qytetari Veliko Qerimi e ka konfirmuar dhe në takimin që ka patur me zëdhënësin e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë datë 24 Korrik 2014.

Qytetari V. Q., ka paraqitur kërkesë në Prokurori për vënien në dispozicion të akteve të procedimit penal nr.1323 të vitit 2011, të kërkuara prej tij në vazhdimësi, ku kërkesa e fundit ka qënë në 04.07.2014, e protokolluar në sekretarinë e atij organi me nr.2182. Këto dokumente janë të domosdoshme në procesin gjyqësor civil që do të zhvillohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 04.08.2014, por deri tani asnjë përpjekje për të realizuar kërkesën e ligjshme të qytetarit V. Q.

E drejta e informimit si një e drejtë themelore dhe e përgjithshme, është një e drejtë kushtetuese dhe si e tillë parashikohet në nenin 23 pika 1 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Në nenin 20 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet e drejta e çdokujt që me anë të një kërkesë formale të marrë informacion dhe dokumente nga çdo organizëm publik, brënda një kohe të arsyeshme, çka do të thotë se si rregull administrata duhet të japë qytetarit informacionin apo dokumentin e kërkuar sa më shpejt.

E drejta e marrjes së dokumenteve, parashikohet dhe në nenin 105 të Kodit të Procedurës Penale i cili bën fjalë për "Marrjen e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve". Sipas pikës 2 të këtij neni është detyrimi i prokurorit për të shqyrtuar kërkesën .

Në këto kushte duke gjetur se ankesa e qytetarit V. Q., është e drejtë, bazuar në pikën 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë Rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike"*, si dhe nenit 21, gërma "b" të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" me ndryshimet përkatëse, i cili shprehet se: *"Pas përfundimit të hetimit Avokati i Popullit, paraqet Rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur, tek organi administrative , që sipas tij, ka shkaktuar shkeljen e të drejtave dhe lirive"*,

## **REKOMANDOJMË**

Vënien në dispozicion menjëherë të akteve të procedimit penal nr.1323 të vitit 2011, për të cilin Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datën 10.07.2012, ka marrë vendim për pezullimin e hetimeve, qytetarit V. Q., nga Tirana.

Lutemi që për qëndrimin që do të mbani ndaj Rekomandimit të vihemi në dijeni sa më parë.

*Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.*

Konc.&Dakt.P.A.  
Tiranë më 01.09.2014

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**